



## Analizë potenciali për nxënës të klasës së 8-të (falas)

### Informacion për prindërit

Nxënësit në klasën e 8-të përballen me një vendim të rëndësishëm në jetën e tyre. Për të mbështetur të rinjtë në marrjen e këtyre vendimeve, landi i Austrisë së Epërme dhe Dhoma e Tregtisë e Austrisë së Epërme mbështesin plotësisht analizën e potencialit.



#### Afati:

1. **Regjistrimi** për analizën e potencialit bëhet me kartën e regjistrimit pranë mësuesit. Ky i fundit organizon edhe takimin për testimin dhe konsultimin, por nuk merr informacion të mëtejshëm për rezultatet e testimit dhe të konsultimit.
2. **JobCoaches (instruktorët e karrierës)** të landit të Austrisë së Epërme prezantojnë procesin e analizës së potencialit dhe ofertat e shërbimit për të rinjtë në një seminar në shkollë.
3. **Testimi zhvillohet në shkollë**, në klasë. Me ndihmën e procedurave të ndryshme të testeve psikologjike, përcaktohen aftësitë, talentet, interesat dhe prirjet e fëmijës suaj.
4. Rreth 2 javë pas testimit zhvillohet **konsultimi në shkollë**. Fëmija juaj duhet të vijë me një të rritur gjatë konsultimit. Data do të shpallet nga mësuesi. Psikologu ynë do të diskutojë rezultatet e testit me fëmijën. Në bazë të kësaj zhvillohet së bashku një objektiv karriere ose trajnimi.
5. Nëse fëmija juaj ka nevojë për **ndihmë të mëtejshme** me hapat drejt arsimit të duhur, mbështetja jepet nga JobCoaches të landit të Austrisë së Epërme. (<http://www.jugendservice.at/>).

#### Kohëzgjatja:

Testimi rreth 3 orë  
Konsultimi rreth 30 min

#### Shpenzimet:

Vlera e analizës së potencialit është 160 EUR. Departamenti i Çështjeve Ekonomike të landit të Austrisë së Epërme dhe Dhoma e Tregtisë e Austrisë së Epërme e mbështesin plotësisht këtë fushatë shkollore.